

Letërnjoftimi i Komunës së

LIPJANIT

2014

Maj, 2015




Fakte

- Më 2014, Komuna e Lipjanit kishte buxhet prej 12 milion eurove, një rritje prej afro 824 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013.
- Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 40.4% të të hyrave të përgjithshme.
- Lipjani ka të punësuar një shërbyes civil për 308 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,016 persona, prej tyre 865 mësimdhënës. Në Komunën e Lipjanit raporti nxënës/mësimdhënës është 33.7. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 298 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Lipjanit është 198.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Lipjani ka vetëm një person të punësuar me kontratë mbi vepër.
- Lipjani gjatë vitit 2014 ka pasur 2,689 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Lipjan rreth 4.5% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Lipjanit funksionojnë 1,474 biznese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 271 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 33 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Lipjanit z. Imri Ahmeti gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 18 premtime nga fusha të ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 22%, mesatarja në shkallë vendi është 24%.

2 Qeverisja komunale


Në zgjedhjet e fundit lokale (2013) qytetarët e Komunës së Lipjanit ia besuan votën për herë të parë z.Imri Ahmeti nga radhët e LDK-së. Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 29,732 apo 54.4% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Imri Ahmeti (LDK) ka marr 53.9%, ndërsa ish kryetari i komunës Shukri Buja(PDK) ka rezultuar me 46% të votave.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 10 ulëse, LDK 9 ulëse, AAK – LDD 5 ulëse, Aleanca për Lipjanin e LVV me nga 2 ulëse, dhe PSD, G.I. Srpska dhe PD me nga 1 ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Lipjanit në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Lipjanit


Më 2014, Komuna e Lipjanit kishte buxhet prej 12 milion eurove, një rritje prej afro 824 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 1,506 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 2.8 milion euro, një rënie e lehtë në krahasim vitin paraprak.

Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Lipjanit dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Lipjanit ishin 1.6 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake.

Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 40.4% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Lipjanit ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komunitat si Suhareka, Mitrovica, Vushtrria, Graçanica, etj., ndërsa më pak se sa Gjakova, Gjlani, Peja, etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për telefona fiks, telefoni mobile, mëditje jashtë vendit dhe udhëtime zyrtare kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë, ndërsa kategoria për riparim të veturave ka shënuar rritje, ashtu siç mund të shihet nga grafikoni 7.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2014 për rrymë elektrike ka shpenzuar 202,101 euro, apo 39,968 euro më shumë se sa viti paraprak.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik

Vitin 2014 Lipjani e ka përmbyllur me 1,506 të punësuar në sektorin publik, 23 punonjës më shumë se në vitin e kaluar. Gjatë vitit 2014 Lipjani ka zvogëluar numrin e punonjësve në administratë, 9 punonjës më pak se në vitin 2013. Vetëm në administratë komunale janë të punësuar 192 punonjës.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Lipjanit




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Lipjani ka edhe 1 të punësuar me kontratë mbi vepër.




Lipjani ka të punësuar një shërbyes civil për 308.3 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,016 persona, prej tyre 865 mësimdhënës. Në Komunën e Lipjanit raporti nxënës/mësimdhënës është 33.7. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Lipjanit



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 298 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Lipjanit është 198.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Numri i bizneseve aktive të regjistruara në Komunën e Lipjanit është 1,474, prej të cilave 19 kanë veprimtari prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 271 biznese të reja, një numër më i madh se ai i vitit paraprak. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 33 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese tregtare.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Imri Ahmeti gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 18 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Ahmeti ka arritur të realizoj 22% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunitat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org